



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr.119, datë 15.07.2019

MBI

**VERIFIKIMIN E KUSHTEVE DHE KRITEREVE LIGJORE
PËR REKRUTIMIN SI GJYQTAR TË KANDIDATIT {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen plenare të datës 15.07.2019, në përfundim të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin si gjyqtar të kandidatit {...}, pasi dëgjoi relacionin përkatës të relatorit të çështjes dhe shqyrtoi materialet e tij,

KONSTATOI:

1. Kandidati {...} është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, për profilin gjyqtar, në përfundim të vitit akademik 2017-2018 dhe për këtë shkak iu nënshtua verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të emërimit si gjyqtar në kuptim të nenit 32 dhe 35 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Procedura e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin si gjyqtar të kandidatit {...} filloi me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82, datë 05.06.2019, nëpërmjet të cilit, me short, si relator i çështjes, u caktua anëtarja e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, znj. Marçela Shehu.
3. Kandidati u njoftua për fillimin e procedurës së verifikimit dhe për relatoren e çështjes, duke mos paraqitur asnjë pretendim ose kërkesë për përjashtim në lidhje me të ose për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
4. Kandidati u njoftua rregullisht për dokumentacionin që duhet të plotësonte dhe dorëzonte në kuadër të procedurës së verifikimit, duke e plotësuar dhe dorëzuar atë në afatet e përcaktuara.
5. Në kuadër të procedurës së verifikimit u administrua dokumentacioni përkatës me të dhënat e nevojshme për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, në korrespondencë me subjektet e përcaktuara në nenin 32 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
6. Nga të dhënat e grumbulluara gjatë procedurës së verifikimit u konstatua se kandidati {...} plotëson kushtin për t’u emëruar si gjyqtar në bazë të nenit 35 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e

gjiqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndërsa ai është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, për profilin gjyqtar, në përfundim të vitit akademik 2017-2018.

7. Kandidati {...} rezultoi se përmbush kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të zgjedhshmërisë për pranimin në Formimin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës dhe, për rrjedhojë, edhe të emërimit si gjyqtar, duke mbajtur në konsideratë për këtë ligjin e kohës së pranimi të tij në Formimin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, Ligjin nr. 8136, datë 31.07.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës dalë në zbatim të këtij ligji, ashtu sikundër edhe ligjin aktual në fuqi, konkretisht nenin 28 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

7.1 Kështu, u verifikua se kandidati:

- a) ka zotësi të plotë për të vepruar, ndërsa nuk ka të dhëna për heqjen apo kufizimin e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- b) është shtetas shqiptar, referuar të dhënave për përbërësit e gjendjes civile të dokumentuar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile;
- c) ka plotësuar kriterin arsimor për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, sipas Ligjit nr. 8136, datë 31.07.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë”, verifikuar nga Shkolla e Magjistraturës në momentin e pranimi në formimin fillestar në vitin akademik 2015-2016;
- d) nuk ka të dhëna të jetë i dënuar me vendim penal të formës së prerë;
- dh) nuk rezulton të jetë i larguar nga detyra për shkaqe disiplinore apo të ketë masë disiplinore në fuqi;
- e) nuk ka të dhëna të jetë anëtar i partive politike;
- ë) nuk mund të ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990, referuar moshës së tij (i datëlindjes 02.10.1989);
- f) nuk ka të dhëna për qenien e tij bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.

8. Kandidati {...} rezultoi se përmbush kriteret e emërimit si gjyqtar sipas shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 35, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

8.1 Kështu, u verifikua se kandidati:

- a) është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar, me 90.35% të pikëve, pra *“është diplomuar me të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme”*;
- b) është vlerësuar me 600 pikë, domethënë “shumë mire”, për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar, pra *“është vlerësuar minimalisht “mirë” për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar”*.

9. Kandidati {...} rezultoi të kalojë testin e verifikimit të pasurisë sipas shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 35, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

9.1 Kështu, nga tërësia e informacioneve të marra në lidhje me pasurinë e kandidatit, nuk rezultoi që ai të jetë përpara ndonjë prej rasteve të skualifikimit nga kandidimi, pra që:

- a) burimet financiare të kandidatit të mos justifikojnë pasuritë e tij;
- b) kandidati të mos ketë deklaruar pasuri, asete ose të dhëna mbi interesat private, që janë të detyrueshme të deklarohen;
- c) kandidati të ketë dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve;
- ç) kandidati të gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

10. Kandidati {...} rezultoi të kalojë testin e verifikimit të figurës sipas shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 35, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

10.1 Kështu, nga tërësia e informacioneve të marra në lidhje me figurën e kandidatit, nuk rezultoi që ai të jetë përpara ndonjë prej rasteve të skualifikimit nga kandidimi, pra që kandidati:

- a) të jetë i dënuar me vendim penal të formës së prerë;
- b) të ketë lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- c) të ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- ç) të ketë qenë ose të jetë bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës.

11. Bazuar sa më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor konkludoi se për kandidatin {...} nuk ka të dhëna që mund të sjellin skualifikimin nga kandidimi për emërim si gjyqtar, prandaj është vendi për kualifikimin e tij dhe vijimin e procedurës së emërimit.

12. Sa më sipër, bazuar në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 97, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenin 35, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në shkronjën “b”, të pikës 12, të Seksionit Ç, të Kreut VI, të Vendimin nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I:

1. Të kualifikojë për emërim, kandidatin {...}, i diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2017-2018 dhe vijimin e procedurës së emërimit të tij si gjyqtar.
2. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet kandidatit.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR